



forcë  
shpejtësi  
strategji  
ndjesi



# PIKËLL PAJ

George Saoulidis

cyberpink

*Handwritten signature*

George Saoulidis

**Pikëll Paj**

«Tektimë S.r.l.s.»

**Saoulidis G.**

Pikëll Paj / G. Saoulidis — «Tektime S.r.l.s.»,

© Saoulidis G.  
© Tektime S.r.l.s.

# Содержание

Contents	6
Конец ознакомительного фрагмента.	24



## Contents

[Title Page](#)  
[Copyright](#)  
[Dedication](#)  
[PJESA E PARË](#)  
[PJESA E DYTË](#)  
[PJESA E TRETË](#)  
[PJESA E KATËRT](#)  
[PJESA E PESTË](#)  
[PJESA E GJASHTË](#)  
[PJESA E SHTATË](#)  
[PJESA E TETË](#)  
[PJESA E NËNTË](#)  
[PJESA E DHJETË](#)  
[PJESA E NJËMBËDHJETË](#)  
[PJESA E DYMBËDHJETË](#)  
[PJESA E TREMBËDHJETË](#)  
[PJESA E KATËRMBËDHJETË](#)  
[PJESA E PESËMBËDHJETË](#)  
[PJESA E GJASHTËMBËDHJETË](#)  
[PJESA E SHTATËMBËDHJETË](#)  
[PJESA E TETËMBËDHJETË](#)  
[PJESA E NËNTËMBËDHJETË](#)  
[PJESA E NJËZETË](#)  
[PJESA NJËZETË E NJË](#)  
[PJESA E NJËZETË E DYTË](#)  
[PJESA NJËZET E TRE](#)  
[PJESA NJËZET E KATËR](#)  
[PJESA NJËZETË E PESË](#)  
[PJESA NJËZETË E GJASHTË](#)  
[PJESA NJËZET E SHTATË](#)  
[PJESA NJËZETË E TETË](#)  
[PJESA NJËZET E NËNTË](#)  
[PJESA E TRIDHJETË](#)  
[PJESA TRIDHJETË E NJË](#)  
[PJESA TRIDHJETË E DY](#)  
[PJESA TRIDHJETË E TRE](#)  
[PJESA TRIDHJETË E KATËR](#)  
[PJESA TRIDHJETË E PESË](#)  
[PJESA TRIDHJETË E GJASHTË](#)  
[PJESA TRIDHJETË E SHTATË](#)  
[PJESA TRIDHJETË E TETË](#)  
[PJESA E TRIDHJETË E NËNTË](#)  
[PJESA E DYZETË](#)  
[PJESA DYZET E NJË](#)  
[PJESA DYZET E DY](#)  
[PJESA DYZET E TRE](#)

[PJESA DYZET E KATËR](#)

[PJESA DYZET E PESË](#)

[PJESA DYZET E GJASHTË](#)

[PJESA DYZET E SHTATË](#)

[PJESA DYZET E TETË](#)

[PJESA DYZET E NËNTË](#)

[PJESA E PESËDHJETË](#)

[PJESA PESËDHJETË E NJË](#)

[PJESA PESËDHJETË E DY](#)

[PJESA PESËDHJETË E TRE](#)

[PJESA PESËDHJETË E KATËR](#)

[PJESA PESËDHJETË E PESË](#)

[PJESA PESËDHJETË E GJASHTË](#)

[PJESA PESËDHJETË E SHTATË](#)

[PJESA PESËDHJETË E TETË](#)

[PJESA PESËDHJETË E NËNTË](#)

[PJESA E GJASHTËDHJETË](#)

[PJESA GJASHTËDHJETË E NJË](#)

[PJESA GJASHTËDHJETË E DY](#)

[PJESA GJASHTËDHJETË E TRE](#)

[PJESA GJASHTËDHJETË E KATËR](#)

[Fundi](#)

Pikëll Paj

Ver 2.0.6

George Saoulidis

Përkthyer nga: Gentian Cane

Të Drejtat e Autorit © 2018 George Saoulidis

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Të drejtat e autorësisë së Imazhit të Kopertinës © João de Souza Antunes Jr AKA Antunesketch

Për Stamatisin, që më njohu me Xhagërin.

**PJESA E PARË**

Peti mori një goditje, dhe trupi iu paralizua krejt.

Ajo e kishte zët kur goditej, dhe ajo shpatë e gjatë budallaqe nuk e mbrojti aspak. Preferonte shpatë dhe mburojë, të kishte diçka që t'i bllokonte goditjet, diçka që t'i mbulonte trupin. Por treneri torollak e detyroi atë të përdorte këtë armë të padobishme.

“Një nga Vajzat e Hijshme rrëzohet poshtë, dhe me sa duket kështu do shkojë dhe për të tjerat,” u shpreh komentatori.

Kundërshtarja që e goditi me shpatën e saj të gjatë, Ekidna e quajnë, vazhdoi të godasë edhe një shoqe tjetër, dhe pastaj Kuik-un e saj. Oh, ajo e bllokoi fare mirë, me të dyja krahët bashkë që mbuluan trupin, por forca e goditjes e bëri të kërcente mbrapa, dhe i hapi rrugën një lojtareje të re, Hidrës. Hidra ishte një Zinxhir dhe mund të arrinte shumë, kështu që gjithçka që i duhej ishte thjesht një nisje. Ajo nisi të luante, me cyber-krahun e saj, një tufë gjarpërinjsh që i përdridheshin anash, duke u shtrirë si kamzhik e duke kërcitur nifullat.

Edhe Kuiku, u rrëzua poshtë, e gjakosur. E paralizuar, ajo u ul në gjunjë mbi një pellg gjaku ngjyrë rozë që po zmadhohej gjithnjë e më tepër, nga viçi i saj i kafshuar.

Peti e kishte kokën në një kënd të pavolitshëm, dhe gjithçka që mund të bënte ishte të kthente sytë nga dyluftimi. Bishat vazhduan me pjesën tjetër të grupit, me daullen që binte ngadalë, shumë ngadalë.

Bisha Kuik, një grua e zhdërvjellët, dhe e imët e quajtur Gorgon, kishte kafkën dhe po luante për të, duke rendur të shënonte.

“Edhe Bisha Kuik po luan për kafkën e fundit. Ja ku po vrapon, sikur më shumë po shëtit, ndërkohë që ndeshja është shumë afër fundit. E përfunduar, si rifinitura Anglet për drurin, llaku më i mirë që mund të blihet me para.”

Daulla bie, është e fundit herë.

Peti pati prapë një ndjesi në gjithë trupin, gishtat e dorës dhe të këmbës iu drodhën, por nuk kishte më kohë të merrte veten. Lëvizja beftas drejt Kuikut, shmangu një gjarpër që po i turrej, avancoi ato pak metrat e fundit duke vënë gjunjët në tokë dhe goditi Gorgon në këmbë. Ajo ra në gjunjë dhe e la kafkën t’i binte poshtë, duke e shkelmuar tutje padashur.

Ekidna i dha një lumë goditjesh me shpatën e saj të gjatë. Peti mezi arriti të mbrohej me shpatë, dhe dëgjoi daullen të binte sërish.

Gorgon gati po e merrte veten. Peti bëri një lëvizje simuluese, që nëse do që e suksesshme, do i jepte asaj një copëz mundësi.

Ekidna u gënjye nga kjo. Lëvizja mbrapa për të shmangur goditjen. Peti nxori shpatën dhe në vend ta sulmonte, e goditi prapë armiken Kuik, këtë herë në qafë.

Lëvizja e saj që aq e shpejtë saqë e goditi atë me shumë forcë.

Diçka kërciti.

“Oh, çfarë goditje nga Peti Ru! A po luante ajo për këtë? Sepse nëse po luante, ishte vërtet një goditje e hidhur.”

Gorgon nuk luajti prapë nga vendi. Vetë Kuiku i Petit e mori veten, dhe duke ecur çalë çalë, luajti për kafkën. Mbrapa saj një vijë ngjyrë rozë.

“Dhe ne kemi Kuik-in e Vajzave të Hijshme që ende po vazhdon, ajo tani nuk dorëzohet, apo s’është kështu?”

“Epo, fundja është ndeshja vendimtare për raundin paraprak të turneut. Vajzat po japin maksimumin e tyre,” tha komentatori i dytë.

Peti vendosi trupin në vendin ku gjendej kundërshtarja. “Pa mburojë, ta marrë dreqi,” foli ajo duke gulçuar. Bëri çmos ta mbulonte Kuikun e saj.

Ekidna bëri përpara, lëvizja e saj që një goditje e beftë dhe tepër e shpejtë, me shpatën drejt e tek brinjët e Kuikut. Ajo u ndal dhe ra në gjunjë, këtë herë nga dhimbja si edhe nga ngrirja në vend.

Mori fund.

Peti hodhi një sy të shpejtë mbrapa tek shoqja e saj e grupit. Ajo nuk po ngrihej më sërish, pavarësisht se sa rezerva gjaku mund të merrte për t’u ringritur.

E shpërqendruar, Ekidna e goditi atë në kraharor.

Kërcitje.

Një tjetër goditje në krah.

“Faull! Arbitrit po i ikte mendja nga kjo gjë, por Ekidna me sa dukej nuk donte fare t’ia dinte.”

Një tjetër goditje në fytyrë. Peti pështyu gjak me ngjyrë rozë, buzët mezi ishin në gjendje të lëviznin nga paraliza.

“Çfarë fundi të dhënë nga Ekidna! Ndeshja e përfunduar për Bishat, por vërtet me një çmim të shtrenjtë. Mjekët por nxitojnë pikërisht në këtë moment, dhe gjendja nuk është e mirë për Kuikun e Bishave. Daullet pushojnë së rëni dhe Gorgon ende nuk po lëviz, o njerëz. Së shpejti në turne mund të kemi viktima.”

Peti, e ngurosur, vështroi mjekët si në ëndërr. Ata e lidhën Gorgon me rrip në qafë, e ngritën me një barrelë, dhe e larguan prej andej.

Një curril gjaku ngjyrë rozë po i rridhte anash gojës.

Një Bishë, me siguri. Armiku, me siguri. Por ajo kurrë nuk kishte për qëllim të dëmtonte ndokënd.

“Dhe nga kqyrjet tona paraprake, ajo do t’ia dalë, o njerëz! Thjesht një dëmtim i shtyllës kurrizore. Me shumë gjasa Gorgon ka dalë jashtë lojës, përgjithmonë. Një nga kuikët më të shpejtë që është parë në Cyberpink, që gjatë gjithë jetës ka marrë një rezultat prej 452 kafka. A do ta marrin veten Bishat nga kjo goditje e rëndë në fillim fare të turneut?”

Një rënkim erdhi nga stolat përreth stadiumit. Fishkëllima jo aprovuese për Peti Ru. Shumë e shumë fishkëllima.

Petin e lanë gjunjët, adrenalina i shteroi nga trupi, rezervat bënë të tyren dhe u duk qartë se po i shpëtonte shurra. Kishin humbur.

Ajo pa mjekët mbi kokën e saj dhe pastaj gjithçka iu errësua.

**PJESA E DYTË**

“Çfarë më duhet që të bëj me këtë?” tha Hektori, duke e shtyrë përsëri fleshin.

Klienti ishte nervoz, e pakta që mund të thuhet. Ai nuk reshte së lëpiri buzët, së kruari bërrylin deri sa i doli gjak, dhe vetëm gjysma e këtyre veprimeve vinte si rrjedhojë e abuzimit me substancat narkotike. “Hajde, o njeri, është kolateral. Do të ta paguaj pjesën tjetër sapo të marr ndonjë fitim. E mora një bakshish o njeri. E mora një bakshish.”

Hektori u ul përsëri në karrigen e tij dhe nxori një psherëtimë të fortë. Ai kurrë nuk rrinte ulur kur një klient i paraqitej në dyqan, por Diego nuk ishte më një klient i mirë. Një klient që ekzistonte prej shumë kohësh, sigurisht, po a ishte një klient i mirë?

Bah...

Kapi një parzmore dhe vazhdoi të punonte mbi të për t’i zënë duart me punë ndërkohë që drogaxhiu i kërkoi ndjesë dhe vazhdoi akoma më tej duke i thënë sesi më në fund arriti rezultatin e tij të lartë dhe sesi i shlyu borxhet.

Rregulloi një pjesë te parakrahu, klienti i ishte ankuar se i ngacmonte lëkurën dhe nuk ndihej rehat nga kjo. Përshtatja e parzmore ishte fusha e tij e ekspertizës, kështu që vetëm mori veglat dhe e rregulloi. Po, lëvizi gishtat në pjesën e harkuar, aty kishte vërtet një buzë të mprehtë që mund të prekte copën. Vetëm një endje shumë të vogël dhe një shirit cope për ta bërë më të butë. Hektori preu shiritin me dhëmbë dhe si mjeshtër që ishte, e ngjiti te vendi. E endi rreth e përçark në dritë, saqë mezi mund të shihje mospërmasë saj.

“O njeri i turneut, ty po të them, do bëhemi të pasur! Jashtëzakonisht të pasur.” Diego e vuri përsëri fleshin mbi tryezë. Me gishtat e tij të papastër, thonjtë akoma më keq, rrobat që kundërmonin erë nga droga, e vuri fleshin mbi tryezë me përlulësi.

Çuditërisht, ishte e vetmja gjë e pastër tek ai njeri.

“Shumë pisët, vërtet” tha Hektori, duke ngritur sytë prapë drejt klientit të tij. “Diego,” i kërkoi ai. “Për të fundit herë, unë nuk jam manaxher sportesh. Unë bëj parzmore. I rregulloj ato. I përshtas sipas porosisë. Kjo është e gjitha çka ka bërë im atë, dhe gjithçka që unë di të bëj. Unë di një lësh në lidhje me sportet.”

“Por-Por kjo është, po ju them, është e përsosur. Vajzat, ato veshin parzmore. A nuk e shikoni, është një ndeshje e bërë në parajsë?” Diego mbështolli duart me njëra tjetrën për ta theksuar akoma dhe më shumë atë që sapo tha.

Hektori mori frymë me zor dhe menjëherë u pendua për këtë. Era ishte... e fortë. “Diego, thjesht ma lër peng dhe, të paktën më sill një pjesë të parave që më detyrohesh,” i përmendi ai atë detyrimin që tashmë i kishte kaluar afati.

“Ejj, o njeri, të besoj ty si gruas sime.”

“Kjo është... uuuu. Thjesht të themi, e gabuar, në kaq shumë aspekte.”

“Dyqani i pengjeve thjesht do ta shesë,” tha Diego, me kokën e ulur poshtë. Pastroi thonjtë e tij me nervozizëm. “Të paktën me ty, e di se do sillen mirë, ashtu si me mua.”

Hektori u kërrus përpara dhe e hodhi parzmoren e kraharorit mënjane. “Diego, të lutem mos më gjyko për keq, por më duhet të ta them këtë gjë dhe do mundohem të jem sa më i qartë të

mundem. S'më duhet fare për gruan tënde. S'më duhet fare për bastet e tua. Më nevojiten paratë që më detyrohesh. Do t'i marrë nesër Kanvasi. Jepi drejtim, shite zinxhirin, sido që të jetë.”

Diego kafshoi buzët, sytë u lëshuan rreth e rrotull, aty jashtë, teposhtë rrugës. Hektori mund ta nuhaste se ai njeri donte t'ia mbathte, por nuk po e ndalte dot. Ishte një rast i humbur. Duhej ta dinte më mirë sesi të punonte me një drogaxhi, por Diego kishte qenë klient i tij për një kohë të gjatë. I ati do t'i kishte dhënë drejtim në çast, por Hektori ishte shumë i butë për të bërë biznes.

Asnjë çudi nuk po i ndodhte.

Karrigia pati një kërcitje. Raftet e tij ishin praktikisht të zbrazët. Klientët e tij jo-ekzistentë.

U kthye beftas me karrige dhe mori një vendim. “Diego, dil jashtë ta marrë dreqi, dhe më sill paratë e mia. Të lutem. Tani më lër të merrem me telefonatat që kam me klientët që aktualisht po paguajnë në mënyrë që të shënoj porositë e minutës së fundit.”

Dhe i ktheu kurrizin.

Diego ngriu dhe nuk tha asgjë për disa çaste. Pastaj doli nga dyqani duke tërhequr këmbët zvarrë.

### PJESA E TRETË

Ai mbylli dyqanin dhe shkoi lart në apartamentin e vet. Shkroi ca mesazhe në email, piu pak uzo të lirë, dhe pastaj ua dërgoi mesazhet klientëve me kriptim PGP. Ishte mesi i natës por dhe klientët e tij nuk kishin tamam një punë me orar 9 me 5, më e pakta që mund të thuhej.

Rrëkëlleu edhe ca gota të tjera me uzo për të marrë pak forcë, dhe pastaj doli në ballkon. Athina dukej e paqtë. Fushëpamja nuk ishte edhe aq e gjerë, vetëm një qiell i mjegullt, me ngjyrë të kafenjtë në të verdhë për shkak të smogut. Ndriçuesit LED në rrugë e tregonin akoma më keq. Ai gjendej në një rrugë paralele me bulevardin Syggrou. Aty kishte disa dyqane, artizanale si e tija, me artikuj të veçantë. Fishekzjarre me porosi, doreza sporti, vegla, lodra seksi. Klientë të një shumëllojshmërie gjërash mos pyet-mos thuaj. Pseudonime, negocime nëpërmjet kanaleve të kriptuara, pagesë në kriptomoneda.

Të gjitha gjërat e zakonshme.

I duhej të kishte 10 mijë për Kanvasin nesër. I hodhi një sy orës nga ai cep shikimi që kishte. Ngeleshin edhe trembëdhjetë orë.

Kanvasi, polici lokal i Mbrojtjes së Zonës, do të vërtitej aty çdo muaj dhe do kërkonte ndonjë thelë. Në këmbim të kësaj, do t'i ofrohej siguri nga rreziqet, sidomos nga ai vetë. Kanvasi ishte një burrë gjigand, si një kullë e lartë plot muskuj dhe forcë. I pëlqente të pallonte djem. Dy djem, në veçanti, që quheshin Mikael dhe Anxhelo. Dhe i pëlqente të bënte shëtitje të gjata teposhtë dyqaneve, ndërkohë që ruante qetësinë, dhe të hiqte gjakun e armiqve të tij për ta lyer pastaj te trupi i vet. I pëlqente ta kishte të lyer trupin me gjakun e një prej djemve që pallonte ndërkohë që vazhdonte të pallonte atë tjetrin.

Vërtet që ekzistonin video dhe gjithçka tjetër për të.

Hektori e kishte parë videon ndërsa mbante sytë mbyllur gjatë gjithë kohës që shfaqej. I duhej ta pranonte se ishte një goxha porno, me dy kushte: E para se njerëzve u pëlqejnë videot me tre gei, gjë që Hektorit aspak. Dhe e dyta, përtej kësaj mund ta merrni mend se për ta mundësuar këtë pjesë pornografike, ndonjëri edhe mund të vdiste nën dhimbje.

Dhe ky njeri zëre se brenda ca orëve, po vinte t'i trokiste te dera.

I harroi emailat.

Hektori u kthye prapë brenda dhe hapi aplikacionin e kriptuar. Do bënte ca telefonata dhe do ngacmonte disa njerëz. E çfarë do bënin ata? Ta vrisnin?

“Po, hollësitë i keni në emailin që jua dërgova. Rregullojeni tani me një pagesë paraprake dhe do merrni një zbritje 50% për dhjetë parzmoret e trupit. Epo, mund ta thonit këtë. Shkëlqyeshëm. Sapo të kryhet pagesa, do lidhem sërish me ju për ndonjë hollësi më shumë që dëshironi, në rregull? Mrekulli, është vërtet fantastike të bëj biznes me ju.”

E mbylli telefonin. Po! Katër mijë euro. Dhe kjo ishte diçka.

Të tjerët nuk i ishin përgjigjur, ose thonin se tani për tani nuk u nevojitej gjë. Hektori pa lajmet, nuk kishte asgjë të tillë si goditje me armë, grabitje, vrasje nëpër kompani, asgjë fare.

Dreq.

Biznesi kishte një rritje galopante çmimesh kur ndodhte një situatë e tillë. E ndjente veten si ata shpendët grabitqarë, por çfarë i duhej të bënte tjetër? Mos të ndihej i lumtur kur një sulm terrorist në qendër të qytetit i sillte pesë klientë të rinj brenda një dite?

I dha fund uzos që kishte ngelur, menjëherë. U lëshua mbi tavolinë, ishte i karikuar dhe kishte akoma një zell që s'po i pushonte. Gjumë? Bah. Do flinte kur të ishte i vdekur.

E kyçi në mendjen e vet profilin social të Kanvasit dhe nisi të ecte rreth e përçark punishtes.

Aty duhet të kishte diçka që mund t'i shpëtonte bythën.

Dhe kjo parzmorë për dyluftim të ashpër? Mund ta përshtaste për atë burrë vigan. Por ishte e rëndë, e shëmtuar madje. E bërë kastile për mbrojtje maksimale. Sigurisht, që të shtinte frikën por Kanvasi nuk kishte nevojë për ndihmë në atë fushë.

Një helmetë? Diçka me shkëlqim? Po çfarë u pëlqente gei-ve? Lulet?

Hektori qeshi nën hundë, ankthi mbi vdekjen që po i afrohej i solli pështjellim, por nuk mund ta ndalte dot. Ja, me mendje vizatoi veten sikur po i tregonte titanit një helmetë me lule, dhe pastaj tek shkelte tamam në vendin ku gjendej një pellg me gjak, ku pastaj Mikaeli fuste fshesën dhe e fshinte lehtë me fëshfërimë.

Jo.

I duhej diçka që Kanvasi ta donte tmerrësisht.

Hektori ndali para asaj që ai e quante mburoja-zuskë. Ai nuk e reklamonte si të tillë, por në këtë rrugë ajo mund të ishte madje një reklamë e mirë.

Ishte një parzmorë e tejdukshme, elastike. Një mburojë-kraharori për gratë, një mburojë që shndërrohej në të lëngshme kur merrte goditje dhe mund ta përthithte një goditje plumbi, e tejdukshme aq sa mund t'u shfaqte trupin dhe/ose të brendshmet e shtrenjta. Rezistente ndaj thikës, ndaj ujit, e rehatshme. Nuk mund të të mbronte nga armët e kalibrit më të lartë por sigurisht që për të do duhej më shumë material mbushës. Kjo kishte një qëllim të veçantë në vetvete, mbrojtje vetjake me stil.

Hektori e ngriti në duar. Ishte e vogël, zor se mund ta mbulonte Kanvasin nga e majta, le më pastaj të gjithë kraharorin.

Ja pra, kjo ishte! Një art i vërtetë. Mund ta thurte me...

Hektori e përplasi parzmoren mbi tavolinën e tij të punës, gjumi i iku krejt, mendja iu bë më e mprehtë se kurrë. Vdekja që po i afrohej, e bën një gjë të tillë te njeriu. Kishte dhe ca orë kohë për të punuar. Dhe mund t'ia dilte. Të porosiste dhe ca pjesë, që do vinin nga ora njëmbëdhjetë...

Kapi çekanin. "Hefest më jep forcë, ta kushtoj ty këtë si pjesën time më të çmuar," murmuriti ai, dhe iu përvesh punës.

#### PJESA E KATËRT

Kanvasi mbërriti në kohë. Ai ecte përpara, dy djemtë që pallonte i kishte në krah, përveç tyre ishin dhe dy burra të tjerë me të. Ishin të rinj, Hektori nuk i kishte parë më parë. Ata qëndruan jashtë duke formuar një perimetër çlodhës dhe Hektori u ngrit të shkonte te dera për t'i përshëndetur.

"Kanvas, o shoku im, dukesh shumë mirë sot!"

"Kurse ti, dukesh si mut," i tha Kanvasi. "Mora një krem zbutës për qeskat poshtë syve siç i ke dhe ti, bën mrekullira."

"Dhe unë do doja ta provoja, të lutem më dërgo ndonjë mostër. Dhe hajde hyr brenda."

Kanvasi rregulloi mitralozin e rëndë që i varej mbi sup dhe psherëtiu. "Kur njerëzit tregohen kaq shumë të sjellshëm, e di se ata nuk do ta kruajnë me mua."

"Kohët kanë qenë të vështira," i tha Hektori, me kokën që i tundej sa lart poshtë. "Por unë kam nja, katër-mijë."

Kanvasi i hodhi sërish një shikim të shpejtë Anxhelos dhe tundi kokën. “Katër-mijë është diçka që mund t’ua tregoj eprorëve të mi, sot për sot.”

“Jo, nuk është nevoja-”

Anxhelo goditi me shkelm një nga ekspozitorët dhe e përplasi poshtë në dysheme. Ai bjondi i vogël kurvë. Hektori u drodh por nuk ia vuri veshin dëmit që iu bë. “Dhe unë kam diçka që besoj se do të të pëlqejë. Le ta quajmë dhuratë.”

Kanvasi ngriti njërën vetull. “Oh?”

“Më ndiq pas, e kam brenda në dyqan.”

Hektori ktheu shpejt shpinën dhe burri gjigand i vajti pas.

“Tani, kjo këtu, është një punë artistike. Është absolutisht unike në gjithë botën, askush tjetër nuk e ka një të tillë.”

Kanvasi rrudhi vetullat. “Është e pazakontë. Çfarë është kjo, një gjysëm parzmorë?”

“Është një parzmorë seksi, o shoku im seksi. Shife. Të lutem provoje, mora guximin ta përshtas sipas masës që ke.”

Kanvasi i hodhi prapë një shikim shkarazi Anxhelos dhe ai kurva ngriti pushkën ca centimentra më lart, për të mbuluar shefin e tij për çdo rast. Kanvasi hoqi rrobat aty në vend, parzmoren që mbante veshur e hodhi pjesë pjesë në dysheme.

“Ka një dhomë për t’u ndërruar aty në të djathtë - Oh, mirë pra, me atë trup që ke, nuk ka asgjë për të pasur ndrojtje.” Hektori e hodhi vështrimin pikërisht te dhoma.

Kanvasi i hodhi sytë përdhe, i nevrkosur. “E si ta vesh-”

Hektori i rregulloi rripat.

“Tani, përfytyro sikur po ecën rreth e qark me këtë, me kraharorin dhe muskujt e tu të barkut tepër të skalitur, tamam ashtu siç do të të pëlqente. Mund ta nxjerrësh në pah, ti mund të jesh Kanvasi!”

Kanvasi pa shëmbëlltyrën e vet në pasqyrë.

Anxhelo iu afrua afër, me pamjen e tij plot epsh.

Po! Hektori iu përmbajt entuziazmit që kish. Por bëri vetëm një gjest duke rënë me grusht kot në ajër.

“Si dukem?” pyeti Kanvasi.

“I jashtëzakonshëm dhe seksi,” fishkëlleu Anxhelo. “Më pëlqen shumë. Në fakt, të dëshiroj ja që këtu.”

“Shkëlqyeshëm. Dhe kjo i ndal plumbat?”

Hektori kaloi krejtësisht në rolin e shitësit të mirëfilltë. “Cilësi e lartë e metamaterialit, e shndërron gjatë goditjes në material edhe më të mirë se Kevlari, që as thika nuk e shpon. Nxjerr në pah format e trupit dhe të mbron në të njëjtën kohë. Kosto tepër e lartë për centimetër, vetëm njerëzit e famshëm dhe VIP-at e korporatave mund ta përballojnë.” Pastaj u kthye dhe tha si padashur, “E vesh Viko këtë.”

Me ta përmendur emrin e njeriut të famshëm, Kanvasi u gjallërua.

“Viko? Seriozisht e ke?”

“Nuk largohet nga shtëpia pa të veshur. Punë sipas klientit, me këto duar ja këtu.” Hektori luajti gishtat. “Ti e di që unë nuk u tregoj klientëve të mi por e di se mund të kem besim te ty.”

Kanvasi i hodhi një sy vetes në pasqyrë edhe disa herë të tjera. Dukej vërtet shumë mirë, Hektorit i duhej ta pranonte këtë gjë. Një titan plot muskuj, inteligjent, i stërvitur, i armatosur gjer në dhëmbë por me pjesë të tejdukshme të endura në vende pikante. Me të vërtetë i jashtëzakonshëm dhe seksi.

Hektori u ndje disi krenar.

Tani sikur të mund të jetonte për të shijuar emocionin.

Kanvasi iu afrua afër dhe Hektori u tremb. Ai i dha një goditje në sup dhe i shfaqti dhëmbët e tij të përsosur. “Më pëlqen.”

Hektori mori frymë për herë të parë gjatë gjithë këtyre orëve.

**PJESA E PESTË**

Timbo dëgjoi zërin e perëndisë.

Me këmbët e zathura që përplaseshin pas mermerit të ftohtë, ai vërtitej rreth e qark stacionit të metrosë.

“Dil jashtë,” i foli zëri i perëndisë.

Timbo hodhi vështrimin lart, dhe pa në çdo cep. Tavani ishte aq i lartë dhe ai e ngriti kokën aq shumë sa që ra me bythë.

“Të thashë, dil jashtë!” buçiti anembanë zëri i perëndisë.

Timbo lëvizi prej andej dhe bëri ca hapa, dhe pastaj u fsheh prapa një qosheje. Me siguri që perëndia nuk mund ta shihte dot tani.

“Prapë mund të të shoh,” i foli perëndia, me zë të kthjellët, që vinte nga të gjitha anët. Zëri i kërciti si një radio e keqe, njëlloj si ajo radioja që gjyshja e dëgjonte gjithmonë.

Timbos i duheshin ca monedha për atë ditë. Nuk e dinte vërtet sesa kishte, por ai mund t'i mbante me pëllëmbë dhe të ndiente peshën e tyre. Padyshim që e kishte marrë shtruar po kasolles do t'i vinte era mut nëse ai do kthehej kështu. Timbo e pa se vendi më i mirë për të lëvizur ishte në krah të kabinave hyrëse. Njerëzit vendosnin biletat e tyre të metrosë në makineri, shtypnin ca gjëra, pastaj ose rrëshqitnin kartën tjetër ose vinin monedha. Ata që numëronin monedhat në kohën kur afroheshin tek makineria ishin ata që Timbo mund t'i mashtronte. Ai u afrohej, fuste hundët, u tregonte këmbët e pista dhe ngrinte sytë për t'i parë me sytë e tij të mëdhenj.

Kështu i thoshte familja gjithsesi. Që ai kishte sy të mëdhenj. Timbo nuk mundte dot t'i shihte sytë si i kishte, por duhej të ishte e vërtetë përderisa kështu këmbëngulnin të gjithë. Dhe Timbo ishte i mirë në këtë gjë, ai u afrohej njerëzve dhe u lutej që t'i jepnin ndonjë monedhë që nxirrte jashtë makineria. Ato dilnin nga foleja plastike që mund të shihej aty poshtë, dhe Timbo përpiquej t'i kapte dhe të rrëmbente ndonjë monedhë më shumë por asnjëra nuk binte. Dhe makineria i gërvishte krahun dhe e lëndonte dhe Timbo thoshte ‘O Zot.

Ja përse perëndia po i bërtiste, për atë që ai gjuante makinerinë që lëshonte monedha.

Timbo pa rreth e rrotull. Ndodhte që stacioni i metrosë të ishte i zbrazët në atë orë. I ndriçuar mirë, çdo gjë funksiononte por nuk gjendej askush tjetër aty rrotull përveç të gjorit Timbo të vogël. Ai u fsheh mbrapa qoshes dhe mbajti monedhat me dorë. Kishte shumë dritë. E dinte se në kasolle do zemëroheshin.

Timbos i duhej të sillte diçka. Të gjithë vëllezërit dhe motrat dhe kushërinjte e tij sillnin diçka çdo natë. Përndryshe do rriheshin dhe nuk do hanin gjë dhe do flinin jashtë. Nganjëherë njerëzit shihnin duart dhe këmbët e pista të Timbos dhe i jepnin ndonjë gjë për të ngrënë, duke i folur atij për lypjen dhe sesi po e shfrytëzonin.

Timbo tundte kokën dhe buzëqeshte dhe mbante pëllëmbën lart por megjithatë e dinte se nuk po shfrytëzohej. Familja ishte familje. Ju thjesht siguroni për familjen, dhe gjithë njerëzit e tjerë së bashku. Nuk i dinin këto këta njerëz?

Dhe kur ishte i madh sa duhej për t'u bërë vetë me fëmijë, merr pjesën që të takon nga vjedhjet e ditës. Timbo kishte një kushëri që tashmë ishte në moshën e duhur për të pasur dy fëmijë të vetët, dhe gruaja e tij sorollatej nëpër gjithë pjesën jugore të Athinës. Timbo i kishte parë të dy sa e sa herë pasi ai e merrte metronë gjatë gjithë ditës dhe shëtiste poshtë e lart. Ata ishin të këndshëm me të dhe e shihnin sesa i zbehtë ishte dhe nganjëherë i jepnin edhe ca monedha që t'i çonte në shtëpi.

Kushuriri e dinte nga përvoja e tij personale sa sa të vështira ishin disa nga ditët.

“Shporru, ti mut, jevgjiti i neveritshëm!” i tha perëndia nga të katër anët.

Timbo u tremb and ia futi vrapit si skëterrë.

Vrapoi në kah të kundërt me shkallët elektrike, duke gulçuar fort ndërkohë e tërhiqnin zvarrë për poshtë. Duke nxituar me të shpejtë, harroi që kjo ishte rruga më e vështirë. Timbo ecte në kah

të kundërt me lëvizjen e shkallëve vetëm kur ishte i mërziur dhe donte të luante. Në nxitim e sipër, ai eci kështu dhe shtyu me duar e këmbë për të arritur sipër.

Doli jashtë. Sytë shpejt u mësuan me rrugën e errët. Metroja ishte aq e shndritshme dhe me atë mermer pasqyrues sa që mund të dukej se aty brenda ishte ditë. Eci ca blloqe, duke parë rreth e rrotull, duke qëndruar në pritje nëse perëndia mund ta shihte prapë atë.

Fatmirësisht, nuk mund ta shihte më.

Timbo mblodhi gishtat e këmbëve. Mermeri ishte i këndshëm dhe i lëmuar, por rruga ishte tjetër lloj. Timbos do t'i kishte pëlqyer të mbante veshur këpucë por tutori gjithnjë thoshte se ai gjithsesi do rritej e do bëhej i madh dhe çka problemi do kishte? Plus kësaj ai dukej më patetik në këtë gjendje dhe njerëzit i jepnin ndonjë monedhë.

Por tani bënte ftohtë dhe Timbo ecte vetëm fare në rrugë. Ai nuk kishte humbur rrugën, e dinte mirë rrugën e kthimit për te qoshja ku ndodhej tutori madje, edhe nëse bëhej vonë shumë, ai e dinte rrugën e kthimit në shtëpi. Nuk e kishte humbur rrugën, jo. Por nuk kishte guxim të kthehej vetëm me aq monedha sa kishte.

Kështu që do gjente diçka tjetër për ta çuar në shtëpi. Duke vjedhur, siç e quanin njerëzit. Familja e tij nuk e quante kështu këtë veprim, por njerëzit zemëroheshin me të vërtetë kur të kapnin duke kryer këtë gjest. Nëse nuk të kapnin, atëherë shkonte në rregull çdo gjë.

Kështu që, Timbos i duhej vetëm të gjente ndonjë gjë për ta çuar në shtëpi. Diçka të tillë ... si balonë? Jo. Si ... copë çokollatë?

Jo jo, as kjo madje.

Diçka ... si çanta e atij burrit? E kishte lënë aty mbështetur përballë dritave të rrugës. Ai qe ulur në errësirë, duke pritur. Nuk reshte së kruajturi krahun dhe as nuk mund të rrinte ulur. Ai i ngjalli frikë Timbos po a kishte zgjedhje tjetër?

Gjithashtu, ai burri nuk ngjante si gjithë të tjerët aty. Ai dukej si njerëzit e tjerë kur flisnin me dikë në telefon, por ai s'kishte telefon, Timbo ishte i sigurt se ai po fliste me veten. Por mendja i rrinte larg, padyshim.

Timbo ishte i vogël nga trupi. Ishte e lehtë për të të ecte qetë pa zhurmë, të përqafonte murin, të qëndronte në hije.

Zgjati dorën e vogël në drejtim të çantës.

Burri u kthye në drejtim të tij dhe Timbo u fsheh prapë, i sigurt se do kapej dhe do merrte ndonjë të rrahur, dhe pastaj do merrte edhe një të rrahur të mirë nga tutori që nuk kishte çuar asgjë në shtëpi.

Por burri vetëm dridhej nga nervat si më parë dhe mermëriste.

Kur hodhi vështrimin tutje, Timbo vendosi të përpiqej ta merrte. E arriti çantën dhe e rrëmbeu. Brenda ishte plot me diçka që Timbo nuk mundte dot ta shihte dhe ishte shumë më e rëndë nga sa e pandehte. Ai foli nëpër dhëmbë dhe ishte i sigurt se burri do ta dëgjonte por ai nuk e dëgjoi aspak.

Timbo e mori çantën me vete, duke e ndjerë peshën që kishte, duke vënë shumë buzën në gaz.

Sonte do çonte diçka në shtëpi.

#### PJESA E GJASHTË

Diego kruante koret e plagëve që kishte në krah. Thuajse ishte në gjendje të dëgjonte zërin e së ëmës që i thoshte të ndalonte, por ai vazhdonte t'i kruante, duke nxjerrë gjak prej tyre.

Nuk mundej dot të bënte ndryshe.

Priste në rrugicë duke u vërtitur në majë të gishtave. Ishte errësirë dhe për dreq s'mund të shikonte. Kërkoj në xhepa elektrikun e dorës që nuk i ndahej asnjëherë. Iu desh shumë sa të kuptonte që e kishte shitur një ditë më parë. E kishte dhënë në shkëmbim të një kanaçeje koka kola. Kishte nevojë për atë kanaçe.

Kruajti koret e plagëve përmes bluzës së veshur.

Ku djallin ishte ai Ukrainasi? Ai tipi ishte shkërdhatë e dyshimtë dhe nuk e trajtonte mirë Diegon, por ishte gjithmonë në kohë. Përpikmëria ishte një karakteristikë pozitive e pazakontë për

të gjithë mafiozët e mirë. Nëse nuk vije tamam në kohë, njerëzit i kapte ankthi dhe tërhiqnin pjesën e tyre.

Kur i kruheshin gishtat e dorës, ishte shenjë që dikush do vritej. Gjithmonë.

Diego lëpiu buzët, duke kafshuar poshtë në plagët e thara. Pa poshtë e lart nëpër rrugën e errët, drejt, po bëhej shumë errësirë! E kush me mend në kokë do bënte një takim në atë vrimë të qelbur muti? Athina ishte një pellg plot me vrima muti por mund të gjeje ndonjë vend me ndriçim për të bërë biznes, o njeri! Dhe një vend ku era nuk frynte fare dhe të ngrinte gjer në palcë.

Rrëmbeu fort xhakëtën. Zor se i shërbente për gjë, xhakëtë e përdorur Turke. Thjesht dukej këndshëm dhe Diegos i pëlqente të ndihej mirë. Kishte nevojë për fije të mira për biznesin e tij. E si do t'ia dilte ndryshe që të fitonte grupin e vet? Kishte Peti Ru-në, dhe kjo ishte një fillim i mbarë. As shumë e lënë pas dore, as shumë e shtrenjtë. Një atlete e mirë në mes të listës. Zot, a ishte me fat ai në këtë bast apo çfarë? Ai Apostolisi i drejt kishte nevojë menjëherë për të holla dhe Diego ishte aty për të vënë bast? Me fat, me fat, tmerrësisht me fat. Apostolisi, ai trapi injorant natyrisht që humbi dhe ia dorëzoi çelësin gruas së Diegos.

Çfarë bekimi i kishte dhënë atë ditë Demetra nga gjinjtë e saj të bëshëm!

Diego kruajti koret e plagëve. I dhembën por u ndje mirë teksa pati njëfarë ndjesie në atë natë të ftohtë. Ah, sikur vetëm të kishte atë elektrikun e dorës, o njeri.

Pa mallin. Katër jelekë të modës HPP. Mrekulli, mrekulli fare, si gjithmonë. Ai Hektor shkërdhata ishte artist me këtë mut, o njeri. Diego kështu i thoshte gjithmonë, jashtëzakonisht i gëzuar që e kishte shok. Aq krenar. Aq krenar, drejt.

Diego kruajti prapë krahun. Pa poshtë në çantë. Ku ishte ai xhuxhi i vogël Ukrainas -  
Më në fund.

Drita makine. Diego ngriti krahun, nuk mund të shihte. Dikush doli prej andej. I shkurtër dhe trashalug, si Ukrainasi. “Drejt, më në fund, o njeri, më ngrinë topet këtu jashtë!”

Burri nuk foli asnjë fjalë dhe iu afrua afër. Diego nuk mund t'ia shihte dot fytyrën.

“Ja këtu e kam atë mutin tënd. Muti i klasit të parë, më i miri në qytet. Nuk do zhgënjehesh.” Ngriti supet ai. “Më duhej të gërmoja për ta gjetur brenda këtyre, nuk ishte e lehtë. Por për ty, dhe me çmimin e duhur ...” nisi të fliste më ngadalë, me zërin e tij që dukej krenar.

Fytyra e Ukrainasit ishte e shëmtuar dhe vrarëlije si gjithnjë. “Hajt pra, Diego. Më trego mallin.”

“Patjetër, do ta tregoj-” Diego ngriu dhe pa nga vendi ku ishte çanta një minutë më parë. “Um...” Kruajti kokën, duke tërhequr këmbët zvarrë nëpër errësirë. Ndoshta e kishte hedhur tutje pa e vënë re? Ndoshta e kishte lënë poshtë ndonjë drite rruge?

“Boll me këto broçkulla, e ke apo jo? Mos më humb kohën.”

“Ishte fiks aty, të betohem! Vetëm një minutë më parë, tamam para se ti të dukesh këtu-”

“Malaka prezoni,” foli Ukrainasi në fjalë profane Greke, dhe nxori diçka nga xhaketa.

Një dritë si vetëtimë, dhe në një moment të vetëm, Diego mund të shihte gjithçka. Rruga e pisët, dritat e thyera, dritaret e mbyllura, makina aty para.

Një ëngjëll i vogël, po vraponte me këmbët e tij të holla dhe të zbathura.

Ai vuri dorën tek barku dhe u bë me gjak.

Diego i murmuriti përsëri një fjalë profane Ukrainasit. Burri nuk ia vuri veshin dhe thjesht e la aty ku ishte.

Drogaxhiu i shtrirë aty në mes të rrugës, një pellg me gjak ishte krijuar aty përçark tij.

Nuk ishte edhe aq ftohtë tani. Edhe të dridhurat nga i ftohti u larguan.

Diego kishte kohë mjaft për të dërguar mesazhin përfundimtar.

PJESA E SHTATË

Diego i dërgoi atij një tekst të pazakontë. ‘Shiko në bufe. Kujdesu për të.’

Hektori u përpoq ta merrte sërish në telefon por telefoni i tij nuk lidhej dot asnjëherë. Ishte tejet mase i lodhur dhe i dërrmuar për t'u marrë tani me mendimet pa lidhje të një drogaxhiu, kështu

që e la fare dhe vajti lart për të marrë një sy gjumë. Sapo preku shtratin, ndjeu se gjumi e rroku të tërin si një batanije.

Pas ca orësh u ndje më mirë. Mezi sa erdhi në vete, por kishte punë për të bërë tani. E shmangu Armadilon teksa gati po e shkelte me këmbë. Kafsha i hodhi një vështrim gjithë zëmërim pasi ai kishte harruar t'i jepte ushqim. Ishte stërvitur të shtypte vetëushqyesin për të marrë ushqim të thatë kështu që nuk rrezikohej kurrë të vuante urie për shkak të neglizhencës, por bastardi tangërlliks pëlqente më shumë gjërat e konservuara.

Hektori pa në bufe. “Po, më fal, Armadilo,” i tha, duke marrë frymë me zor, “rregullohu me ushqimin e thatë. Nuk kam blerë ushqim as për vete, kam qenë shumë i zënë duke u siguruar me vete se ishe gjallë dhe jo i vdekur.”

Armadilo u gjallërua dhe lëvizi poshtë e lart këmbët e përparme.

“E di se do të mbijetosh. Por për mua plakun e butë?” Hektori e hoqi vëmëndjen prej tij. “Ah... Do shkoj në dyqan për të bërë pazar, gjithsesi jemi drangull fare.”

Dita u duk e këndshme. Qyteti ishte akoma i shpifur, por të kishte më shumë jetë bënte që gjithçka të dukej e mbingopur, ngjyrat, erërat, jeta rreth e qark tij. Normalisht do merrte kamionin, edhe për ta ngarë fare pak, por sot donte të ndiente ajrin, të mbytur në monoksid karboni. Përshkoi bulevardin Syggrou, duke shpërfillur prostitutat që rrinin në qoshtet e tyre. Kaloi dy rrugë për të arritur tek kryqëzimet e zakonshme të Diegos, që ishin prapa një vendi bastesh.

Hektori nuk ishte tip i sportit. Për herë të parë në jetën e tij, ai vuri re disa postera dhe informacione që njoftonin për futboll, basketboll dhe gara Formula 1, me makina klasike dhe elektrike, por sytë i ngelën tek turneu Cyberpink. Ishte disi e vështirë mos të ngelnin sytë aty. E gjitha ajo ishte bërë e atillë që të tërhiqte syrin mashkullor ndërkohë që të rripte dhe ca para nga kursimet e tua.

Hodhi disa hapa brenda vendit të basteve. Ekране mbi ekране mbushur me shifra dhe informacione, transmetime dhe ritransmetime ndeshjesh, të gjitha të kontrolluara në AR dhe të gjitha me efekte holo zanore dreksionalë që do të thotë se çdokush mund ta shihte lojën tamam ashtu siç dëshironte, duke bërë që vendi aty të kishte një efekt jehone sikur që mbushur me fantazma. Burra dhe gra vinin baste mbi skuadrat, rezultatet, lojtarët, MVP-të, dhe për çudinë tepër të madhe të Hektorit, edhe mbi dëmtimet e lojtarëve.

E kuptoi se nuk dinte hiç fare në lidhje me Cyberpink-un. Kishte edhe disa femra, në skuadra? Dhe diçka si kafkë pak a shumë? Kafkë qeni, për ndonjë arsye? Dhe pikë?

Kjo ishte krejt gjithçka sipas njohurive të tij. Implanti i shfaqti një rezultat kërkimi në AR-në e tij por që ai e fshiu fare. Ndihej tepër i lodhur për të mësuar gjëra të reja pikërisht në këtë moment.

Ku ishte Diego? Ky ishte vend kryqëzimi ku rrinte ai. Pyeti dyqanxhiun.

“Eh, o njeri, edhe ai të ka pasur borxh ty?”

Hektori pa se ai foli në kohën e shkuar. “Po, por nuk është kjo që po kërkoj. Në fakt e njoh bastardin prej shumë vitesh tani.”

“Oh, atëherë më fal, o njeri. Ngushëllimet e mia.”

Hektori bëri një hap mbrapa. “Çfarë dreqin do të thuash?”

“Këtë mëngjes ai iku në atë botë, o njeri, vetëm dy blloqe më tutje. Ishte i drobitur nga të gjitha drogërat që merrte dhe humbi gjak para se ta ndihmonin njerëzit. Më vjen keq, vërtet që më vjen. Dhe ti nuk i merr dot ato para që t'i kishte borxh, Diego nuk kishte as llogari bankare, asgjë hiç. Edhe mua më kishte borxh ai, kisha një haker që ma kontrolloi.”

Hektori i bëri një buzëqeshje nga zori. “Sa i mençur je në biznes,” tha ai duke bërë humor anglez.

Burri ngriti supet. “Kështu qëndron puna, o njeri. Nëse do e dije sesa shpesh më duhet ta bëj këtë gjë, nuk do më gjykoje kështu. Gjithsesi, a të intereson të vësh një bast? Bishat duken në formë për të marrë kupën këtë vit.” Ai ngriti një ARO me pëllëmbën e tij, një Objekt me Realitet të Zmadhuar që mund të shihej nga çdokush në film, që nënkuptonte çdonjeri të thjeshtë që gjendej në

planet. Një grua me mburojë, seks bombë, me të pasmet e ngritura dhe buzët tepër joshëse. “Është Sirena, e preferuara ime. E mrekullueshme, apo jo? Cila prej tyre të pëlqen?”

Burri hodhi sytë lart dhe u duk sikur donte me të vërtetë ta njihte.

“Uh. Nuk jam një djalë i prirur pas sportit. Ku thatë se Diego iku në atë botë?”

Dyqanxhiu preku me gisht një numër rruge dhe ia dha hartën Hektorit.

“Faleminderit.”

“Asgjë. Hajde vër një bast për Sirenën, në rregull? Paratë janë të garantuara!” i foli më zë të lartë pas tij.

PJESA E TETË

Askush nuk e kishte vënë ujin në zjarr për të pastruar gjakun.

Hektori qëndronte aty me duart brenda xhepave të xhaketës. Gjaku ishte i kuq në balluket e flokëve, i tharë, dhe tani dukej me ngjyrë të zezë në kafe. Nuk ishte në ngjyrë rozë. Kjo nuk ishte një ndeshje sportive. Nuk ishte një shfaqje në film, apo në rrjet, ose në VR.

E njihte Diegon për më shumë se 10 vite, dhe ishte goxha kohë duke ditur se qe vetëm 30 vjeç. Praktikisht, një jetë e tërë e një djali të rritur. Nuk e kishte shok të vërtetë, por bastardin e njihte fare mirë.

Ishin bërë tapë disa herë së bashku, po ashtu kishin qeshur. Dhe më pak kur ai ishte bërë i varur nga droga, që atëherë prisnin herën tjetër kur piqeshin bashkë me Diegon. Ai kurrë nuk kishte qenë ndër më të mirët klientë të tij por gjithmonë i kishte shlyer borxhet me intel nga rruga dhe shumë mënyra të tjera. Shumica ishin vërtet një mut, por disa nga bakshishet e tij aktualisht ia vlenin.

Po tani, ajo çfarë kishte mbetur prej tij ishte një njollë ndryshku në anë të rrugës. Një qese e flakur ushqimesh e vënë aty mbi gjakun e tharë.

Plehra e vënë sipër plehrës.

Kaloi një gjysëm ore tjetër duke ecur lart e poshtë nëpër po atë rrugicë, duke u përpjekur të kontaktonte me dikë në telefon. Trupin e Diegos e kishin marrë dhe do merrej në zotërim nga qyteti i Athinës. Ai donte që ta riciklonin, dhe prej tij të kishte një pemë që rritej. Hektorin e njoftuan se shoku i tij me sa dukej ishte një adhurues i Demetrës.

Hektori vuri buzën në gaz i befasuar. Nuk e kishte njohur këtë anë të tij të vetëdërgjegjësimit ndaj ambientit. Qyteti e refuzoi kërkesën e bërë me dëshirën e tij, natyrisht për mungesë fondesh. Madje edhe një kishë e madhe nuk u jepte lëmosha apo ndihma njerëzve. Veçanërisht atyre që vdisnin.

Hektori u mendua për një çast.

“Do të paguaj për funeralin, sipas dëshirës së tij. Më dërgo faturën.” 1200 euro, thoshte emaili.

Kontrolloi llogarinë e tij bankare. 1700 euro. “Thjesht do të ta shtoj tek pjesa tjetër që më detyrohesh, o bastard trap,” i tha ai vendit të njollosur me gjak.

“Më fal, zotëri?”

“Asgjë. Do merrem unë me këtë, ja tani.”

Mbylli telefonin, pagoi faturën elektronikisht dhe shkoi për të bërë pazar në ushqimore, edhe pse thjesht mendimi për të ngrënë ushqim tani për tani i sillte të përziera në stomak.

PJESA E NËNTË

Pasi u kthye në dyqanin e tij, Hektorin e kaploi një mendim shqetësues. Lexoi tekstin e fundit që kishte dërguar Diego dhe ia lexoi me zë të lartë Armadilos.

“Ke ndonjë ide? Fare?”

Vuri poshtë veglat e punës dhe shkoi aty përpara. Qëndroi në vendin ku Diego kishte qëndruar herën e kaluar kur ishin takuar. Atë herë kur ai i kishte kthyer shpinën. Pa rreth e rrotull.

Bufeja në të djathtë, afër me daljen.

E hapi.

Fleshi ishte aty. I pastër. I çmuar.

Ai bastardi tinëzar. I kishte kthyer shpinën, sa, pesë sekonda? Dhjetë, e shumta?

Hektori e kapi fort dhe pastaj shkoi të takonte zejtarin tjetër që e njihje.

#### PJESA E DHJETË

“Mrekulli zemër ja ku qenke,” tha burri trashalug, duke lëvizur kursoren në kompjuter. Dhoma e hakerit ishte plot me kompjutera të prishur dhe pije freskuese.

“Toni, ende nuk e kuptoj këtë gjënë mbi pronësinë e blokçein-it.”

“Shkelës, o njeri. Është emri im -” u ankua hakeri.

“Kurrë nuk do të thërras kështu. Tani boll më harxhove kohë. Sqaroje,” tha ai, me pamje të mërzhitur, duke e shtyrë që të vazhdonte më tej.

Toni, hakeri piu një gllënjë dhe u fut në mendime. “Shiko, blokçein-i është publik dhe i pandryshueshëm. Është një regjistër publik i kujt që dërgon çfarë.”

“Unë përdor kriptomoneda, i kam pak a shumë. Në rregull. Si më hyn në punë ky shkopi?”

“Ky shkopi thjesht mban paramonën, tastin thurje të pronësisë së një atleti të caktuar. Në këtë rast, është e njëfarë Peti Ru,” Toni paraqiti imazhin e një atleteje.

Emri	Patricia Georgiu
Pseudonimi	Peti Ru
Forca	2
Shpejtësia	1
Strategjia	3
Sensualiteti	1
Madhësia e Kupës	D
Rritjet	21%
Skuadra	Vajzat e Hijshme (Zëvendësim i Përkohshëm)
Pozicioni	Sulmuese (Shpatë dhe Mburojë)
Fitore	4
Humbje	67
Të ardhurat	4500
Sponsorizimet	Asnjë

Hektori u përkul përpara, çuditërisht jo më i mërzhitur. “4500 të ardhura, pra euro në muaj?” Fishkëlleu ai. Nuk ishte ndonjë fat kushedi, por atij i duheshin tre porosi të plota për të arritur atë nivel të ardhurash me dyqanin e tij, gjithashtu ai kishte edhe shpenzime dhe kosto materiali që duhej t’i merrte parasysh.

“Po. Më lër të ngarkoj Aplikacionin e Pronarëve të Cyberpink-ut te filmi jot...”

Sapo u shfaq, Hektori preku me gisht tastin instalohet, sytë nuk i hiqeshin nga faqja e të dhënave.

“Dhe tani tasti thurje të pronësisë...” Toni preku me gishta tastierën. “Të presim për ca sekonda. Tre konfirmime. Shtatë. U krye.” Ktheu karrigen dhe provoi një lëng portokalli plot me sheqer. “Ti tani je zotëruesi krenar i një atleteje Cyberpink. Kontrata paramone e saj të përket ty.”

Hektori u ul përsëri dhe mori frymë. “Dhe unë thjesht jam bërë një pronar skllaveje? Kështu është? Po si është e ligjshme kjo?”

“Borxh,” Tha Toni, duke pickuar ajrin përpara sikur fjala t’i rridhte nga gishtat. “Borxh dërrmues, masiv. Nuk është skllavëri, në aspektin jo teknik. Është varësi me borxh. Vajzat thjesht shlyejnë atë çfarë u detyrohen korporatave me anë të ardhurave që nxjerrin. Natyrisht, dëmtimet dhe kostot e mirëmbajtjes vazhdojnë të bëhen kapicë, bashkë me interesin dhe tarifat për vonesat. Është e gjitha përsosmërisht ligjore sipas kontratave që kemi nënshkruar ne të gjithë, dhe ato u nënshtrohen Cyberpink-ut për vite me radhë para se të jenë afër shlyerjes së borxheve që kanë.”

“Kështu që unë nuk kam një skllave, thjesht kam borxhin që më detyrohet ajo, derisa ajo ta shlyejë, teknikisht ajo është e imja, dhe bëj me të çfarë dua unë.”

Toni lëpiu buzët me një mënyrë të neveritshme. “A ke ndonjë ide?”

“Po!” Tha Hektori, me sy të zgurdulluar. “Unë do ta vë atë të punojë dhe të shlyejë borxhet e mia.”

#### PJESA E NJËMBËDHJETË

Morën kamionin e Hektorit dhe vajtën në stadiumin e Cyberpink-ut. Rrugët ishin plot me njerëz që vinin për atje, autobuzët zbraznin grupe të tërë tifozësh, vetura të parkuara ngado dhe në çdo cep.

Zhurma, muzikë elektronike, stenda me hot dog dhe stenda me ushqime speciale greke, njerëz që bërtisnin, të acaruar.

“Kurrë nuk e kam kuptuar tërë këtë që quhet tifozëri sporti,” pohoi Hektori, duke u vërtitur rreth e rrotull.

Toni bleu ca pije freskuese. “Oh, paske humbur shumë. A nuk të ka sjellë yt atë në ndonjë ndeshje?”

“Im atë më ka mësuar si të bëj parzmore.”

“Duket interesante. Epo prapë, bëhet fjalë për jetesë, apo s’e kam gabim? Të shkojmë atje tej, porta C, aty janë vendet tona.”

Hektori vajti pas hapave të burrit trashalug ndërkohë që ai shtynte përpara turmën e njerëzve. Kurrë nuk i pëlqenin turmat, e bënin të mos ndihej rehat. I pasigurt. Do mund të kënaqej të paktën me dy parzmore të tizat tani për tani, madje dhe ato më të lehtat. Jeleku që vuri zor se e bënte të ndihej tamam i mbrojtur. Njerëzit ranë mbi të, njëri i hodhi çurk ca keçap nga hotdog-u që mbante dhe madje nuk kërkoi as ndjesë, fëmijët e goditën me këmbë ndërkohë që i mbanin për dore prindërit, dhe gjuanin të tjerët rreth e rrotull pa u ndëshkuar aspak.

Çmenduri.

Vajzat e Cyberpink-ut gjendeshin kudo rreth e rrotull tyre. Në postera gjigande, në holoprojektione që ngjanin si të gjalla, në ARO që kishin një buton të volitshëm ‘Bli Tani’ nga i cili dilte një version i animuar me rezolucion të lartë.

Ngjyra, trupa, gjokse, ushqime të hedhura, pije alkolike, por gjithsesi ishte gjithçka akoma e favorshme për fëmijët, e përshtatshme për të gjithë familjen. Të sillje djalin tënd në një ndeshje Cyberpink-u, ishte diçka për t’u mbajtur mend kur ai drej qerratai bëhet adoleshent dhe nuk dëshiron më të rrijë me ty.

Eksese.

Bukë dhe cirk.

Hektori tundi kokën. Kë po vinte në lojë ai? Përkundrazi, ai tani ishte pjesë e sistemit, një pronar krenar i një atleteje. Këtë mezi mund ta besonte.

“Hajde pra!” Bërtiti Toni dhe ia bëri me dorë që të ngjiste shkallët e stadiumit.

Vendi ishte i mbipopulluar. Hektori u ul, iu desh të shtynte pakëz me bërryl Tonin ‘pasi ai zinte ca si shumë vend. Stadiumi ishte shumë më i vogël se një fushë futbollli, me kupolë të mbyllur, por me të njëjtat drita verbuese që ndriçonin poshtë në bar, ekranin gjigand, fotografët dhe kameramanët që qëndronin përbri fushës së ndeshjes.

Natyrisht që mund të ngarkoje gjithçka në film dhe ta shihje të gjithën nga çfarëdo këndi që do dëshiroje. Gjithçka vetëm me një abonim tepër të lirë prej 14.99 euro. Reklama i doli Hektorit mu para fytyrës, krejt e paligjshme në vende të tjera, s’mundeshe thjesht të rrëmbeje filmat e njerëzve kështu pa lejen e tyre, por ata i kishin pranuar termat dhe kushtet e Dionisos Entertainment kur kishin blerë biletat.

Shtëpia e tyre, rregullat e tyre.

Një atlete gjoksmadhe Cyberpink-u u tund përpara tyre, dhe ai u përpoq mos t’ia vinte veshin ARO-s që po e bezdiste.

Toni e preku prapë me bërryl, duke u zgërdhirë. “Ti mendon se kjo është një budallallëk.”

“Po, pra.”

“Por ti je prapë disi i eksituar.” Ai i ofroi një pije freskuese.

“Më duhet ta pranoj se jam. Jo, faleminderit, vërtet që nuk dua të përdor banjon këtu. Kështu që më trego gjithçka për këtë qelbësirllëk. Nuk di gjë fare për këtë.”

“Asgjë? Uauu. Në rregull, ja të shohim. Loja xhagër është sport i thjeshtë, por shumë zbavitës.”

“Është si futbollli me armë në mesjetë, apo jo?”

“Po shumë i ngjashëm. Dy skuadra nga secila anë, me pesë atletë në çdo skuadër. Një kuik, një zinxhir, tre sulmuese.”

“Kaq është?”

“Kjo është e gjitha që nevojitet. Por komplikohet shumë shpejt, kështu që më lër të ta sqaroj.”

Ndeshja ishte gati të fillonte. Ranë boritë, buçiti muzika, tifozët u shpërndanë rreth e rrotull për t'u ulur nëpër vende.

“I vetmi që mund ta mbajë kafkën me vete është kuiku i çdo skuadre. Kështu që të tjerët mundohen ta mbrojnë atë, ndërkohë që godasin skuadrën kundërshtare.”

Stema e Dionisos vetëtiu në mes të stadiumit. Tifozët ulëritën.

Vajzat e Hijshme vrapuan në një formacion të çrregullt brenda në stadium. Ngjyrat e skuadrave të tyre ishin jeshile dhe e bardhë. Ato qëndronin të gjitha bashkë, tamam si bukuroshet në kohët e vjetra. Duke ngritur të pasmet lart, duke fryrë kraharorin, dhe duke ngjeshur buzët.

Tifozëve u iku truri, duke bërëtitur si të çmendur, duke shprehur publikisht deklarata dashurie, duke shkrepur kamerat për të kapur ndonjë copëz sado të vogël prej atyre femrave tërheqëse.

Njëra nuk ishte edhe aq gazmore. Ato e kishin mbuluar me mjeshtëri nga mbrapa. “Ajo është?”

“Po, ajo është vajza jote. Pa të ofenduar o njeri, por vërtet që ajo ngjan se nuk i përket këtyre Vajzave Bukuroshe.”

“Asnjë s'e mori,” Foli nëpër dhëmbë Hektori duke mos ia hequr sytë investimit që sapo kishte bërë. Po, ajo ishte ndryshe, në rregull kjo. Flokë të shkurtër, forma të zmadhuara të trupit në kontrast me pjesën tjetër të Vajzave të Hijshme të cilat kishin vetëm një model gjoksi, parzmore të vërtetë, që Hektori nuk mund ta shihte qartë prej aq larg sa ishte por tashmë e kishte pranuar. Ajo mbante një qëndrim ‘seksi’ të pazakontë, që dukej qartë se përpiquej jashtëzakonisht shumë dhe nuk ia dilte dot ta bënte mirë.

Stadiumi shpërtheu në britma. Hektori mendoi se do shurdhohej fare. Anonçuesi mezi mund të dëgjohej. Skuadra kundërshtare hyri brenda, dhe turma brohoriti, duke u ngritur në këmbë, duke hedhur ushqimin lart në ajër, duke tronditur fort portat prej metali ndërsa rojet e sigurisë përpiquehin të ulnin gjakrat, duke i shtyrë pa i vrarë.

“Zonja dhe zotërinj dhe variacione të tyre, po ju prezantoj me të Daaashurat e Shkaaatërrimit!” foli anonçuesi me zërin e tij buçitës.

“Ma ha mendja se ato janë favorite për të fituar ndeshjen?” Bërtiti Hektori që ta dëgjonin.

“Sigurisht që janë. Eh o njeri, dua për veten time disa nga Vajzat e Hijshme ndonjë ditë jave, por të Dashurat... Epo, ja do ta shohësh.” Ai puthi majat e gishtave.

“Oh, uauu, paskan disa parzmore të bukura,” Tha Hektori, duke çmuar vlerën e çdo mjetei ndërkohë që të Dashurat vajtën prapa dhe ai i pa to në një fotografim nga afër në AR.

Toni u kthye nga ai. “Çfarë je ti, pa bole?”

Hektori sikur u mbyt. Tundi kokën, duke u sqaruar, “Jo-Po, ato janë të nxehta, por parzmoret e tyre janë vërtet të mira, nuk po tallem.”

Toni turfulloi. “E djallose fare, miku im.”

Dy skuadrat zunë vendet e tyre në fushë. Një arbitër vendosi një kafkë në mes të fushës, dhe ato pritën në rresht në secilën anë të fushës. Prapa tyre kishte një piring me diçka të butë në ngjyrë portokalli. Ato mbanin armë, shpata dhe një top dhe zinxhir, që dukej sikur ishin bërë me material prove, me cepa të butë dhe maja shumë të mëdhaja.

Pastaj një daulle nisi të binte me furi, duke ushtuar me jehonë nëpër të gjithë turmën e zhurmshme.

Atletet u turrën përpara, duke e përshkuar distancën në një sekondë. Hektori nuk mundi dot ta ndiqte aksionin. Dikush gjuajti një tjetër, ajo tjetra ra në gjunjë, ato me trup të vogël vrapuan për kafkën, u goditën por një tjetër iu kundërpërgjigj me krahët? “Po pse dhe ato të tjerat nuk po i kundërpërgjigjen me krahë?”

“Vetëm kuikët munden ta bëjnë, mbylle tani,” Foli Toni i përqendruar tek aksioni i tyre teksa rrëkëllente ndonjë gllënjë.

Diçka ndodhi andej nga mesi, shpatat u vërvitën, një grua ra me kurriz, aksioni vazhdoi më tej. Një top dhe zinxhir u tundën duke bërë një hark të madh dhe goditën një nga Vajzat e Hijshme, koka i vajti anash dhe ajo u zmbraps me aq shumë forcë sa kërceu gati pesë metra prapa, gjaku rozë që spërkatej nëpër ajër, dhe turma që po egërsohej.

Pastaj një kuik goditi kafkën duke e rrëzuar poshtë.

Një arbitër i ra bilbilit. Horaci u shokua. “Ça drejtin? Njëmbëdhjetë sekonda dhe sapo shënuan?”

Të njëjtat veprime u përsëritën prapë, e gjora vajzë u godit në fytyrë, koka po i lëvizte mbrapa përsëri, gjaku rozë plasi në ajër.

“Cyberpink. Është sporti më i shpejtë që ka ekzistuar ndonjëherë. Do të mësohesh me të. Shtypi përsëritjet e ndeshjes tek filmi që ke. Do ta kesh më të lehtë, sapo t’i kuptosh rregullat.”

“Në rregull. Ka mundësi që të ngjaj si trap me këtë pyetje, por pse gjaku është rozë?”

“Oh, ja. Është vërtet pyetje naive. Sepse rregullat e transmetimit thonë se nuk mund të shfaqësh gjakun në ekran, kanë një AI të mësuar me makinë që ndryshon në kohë reale ngjyrën e gjakut gjatë transmetimit.”

“Por ne nuk po e shohim në transmetim. Është këtu, drejtpërdrejt.” Hektori hapi pëllëmbën ngadalë në drejtim të ndeshjes.

Toni ia bëri me dorë. “Është një dritë me gjatësi vale të caktuar, plus edhe ca AR të patejdukshëm dhe ngjan rozë, edhe kur gjendesh këtu në stadium.”

“Uauu. Është...”

“Fantastike, apo s’është kështu?”

“Të bën të vjellësh. Është... e neveritshme.”

“Oh, vërtet? Dua ta shoh fytyrën kur të marrësh çeqet e parave nga ndeshja, o pronar.” E tha këtë fjalë sikur të kishte shije të hidhur.

Hektori e mbylli gojën. Sigurisht, ai ishte hipokrit. Por çfarë mund të bënte? Biznesi po i shkonte keq. Nuk ishte puna se ai kishte kërkuar të kishte një atlete në pronësi, thjesht i ra në prehër. Mund ta shiste sa më shpejt të qe e mundur dhe të merrte një fitim të mirë. Toni do qe tepër i lumtur ta lidhte me njohjet që kishte në treg dhe të sigurohej se gjithçka shkonte mirë.

Ata e morën Vajzën e Hijshme me barelë dhe u bë një zëvendësim. U fut në lojë Peti Ru. Ajo mbante një shpatë të gjatë dhe dukej në siklet.

E kush nuk do ishte? Një pjesëtare e skuadrës kishte dalë jashtë, tashmë kishin humbur një pikë. Kjo lojë ishte në krisje të plotë.

Daulla nisi të binte sërish dhe atletet u turrën përpara, dhe përsëri një lumë goditjesh dhe kundërpërgjigjesh dhe sulmesh të befta dhe të bërtiturash dhe...

Kuiku shënoi.

“Ça drej muti!” Thirri Hektori dhe u ngrit në këmbë, ndërsa turma rreth e qark rënkonte bashkë me të.

Toni u zgërdhi dhe piu një gllënjë. “Je dhënë i tëri tani pas lojës, apo jo?”

“Ëc tani, ka kaluar vetëm një minutë dhe ne jemi duke humbur?”

“Mos u bëj merak, atletet paguhen njëlloj, si të fitojnë si të humbasin. Fitueset natyrisht që marrin bonuse,” foli nëpër dhëmbë, duke tundur kokën. “Edhe sponsorizime, edhe mallra, edhe seks, edhe-”

Hektori ia bëri me shenjë. “E kuptoj.” Ai u ul përsëri, duke u lëshuar mbi stol. “Unë kam një humbëse tani.”

“Po. O njeri, ti harron se kush ka qenë pronari i mëparshëm. Ka qenë Diego, o njeri.”

“Po,” ia ktheu ai duke nxjerrë frymën.

“Ka një ndërprerje publicitare tani, unë po lëviz njëherë. Duhet të kisha dëgjuar ty për pijet freskuese.”

#### PJESA E DYMBËDHJETË

Hektori tërhoqi flokët.

Kjo ishte tepër stresuese. Ndeshja vazhdonte, ai mezi mund të rezistonte. Shpatat dhe shtizat dhe topat-me-zinxhirë fluturonin në ajër dhe godisnin gjithkënd rreth e përfaq.

Nuk e kishte fare idenë se çfarë po ndodhte. Shtypi përsëritjet e ndeshjes dhe pa Peti Ru-në.

Ajo ishte mirë në këtë gjë, por diçka nuk shkonte. Gjithë precizion vërviti shpatën e gjatë, shmangu shumë prej goditjeve, duke iu dredhuar atyre me rreth dy centimetra e gjysëm. Por skuadra kundërshtare si një e tërë dukej se ishte më në formë.

Shumë më në formë.

Të gjitha Vajzat e Hijshme u duhej të nxirrnin në pah gjokset. Hektori pa të dhënat e tyre. Sensualiteti, 3. Sensualiteti, 2. Sensualiteti, 3. Ato të gjitha ishin të dhëna me vlerë. Sigurisht, që bëhej një reklamë e mirë, por nuk do t'u mundësonte të fitonin ndonjë ndeshje tjetër. Me bythë apo pa bythë, prapë ishte sport, e mori dreqi!

Apo, ndoshta nuk kishte fare rëndësi kjo?

Hektori gati sa nuk po shkulte ndonjë tufë me flokë. Nga këndvështrimi i biznesit, kjo ishte gjë pa tru. Vajzat e Hijshme veshën parzmoret e imta që zor se i mbulonin trupat e tyre, që më shumë tentonin t'i tregonin sensuale sesa t'i mbronin. Helmetat natyrisht që as nuk diskutoheshin.

Nuk ishte çudi që ato gjendeshin përdhe në tokë. Dy atlete ishin jashtë loje, duheshin javë të tëra për të marrë veten dhe ndoshta me dëmtime të përhershme?

Kot fare.

U ul në cep të stolit, thujse gati për t'u kthyer prapë në dyqanin e tij dhe t'u merrte këtyre vajzave të gjora ndonjë pajisje të përshtatshme. D.m.th që për drej, edhe pajisja më e lirë që kishte, do e kishte zbrapsur atë goditje që u kushtoi atyre një pikë.

Armët supozoheshin të ishin të cilësisë për stërvitje, të buta, me shkumë, plastike. Por forca është e barabartë me masën shumëzuar me atë drej nxitim, dhe kur kishit cyber-krahë që vërtiteshin me aq shumë fuqi sa nuk kishte rëndësi nëse ishin me shkumë apo jo. Prapë t'i thyenin dhëmbet.

Gjak. Kjo ishte loja. Dyluftim, kjo ishte shfaqja.

Por ajo çka rridhte prej kësaj ishte e gjitha acaruese. Nuk u bëhej vonë këtyre njerëzve për këto femra të gjora, aspak nuk u bëhej vonë? Më e pakta fare, ata mund të mbronin investimet e tyre. Nuk kushtonte shumë të blije një atlete, edhe në këtë ligë koti të kategorisë së tretë.

Duke u shtyrë në mes tifozëve Toni u kthye, dhe u ul. “O njeri, më zgjati pafund shurra. Si përfundim, e lëshova në një kasolle aty afër banjove.”

“Është bukur ta dëgjoj këtë,” U zbraps Hektori.

“Çfarë humba? Oh, dhjetë pikë përpara? Më vjen keq, o njeri, nuk ka bonus sot.”

“Nuk duket të ndodhë ndryshe, ashtu është. Por...” Ai u zhyt në mendime. “Dua të them, ato...”

Dallja nisi të binte sërish dhe Peti u hodh në sulm. Ishte e ngathët, dukej qartë se akoma po merrte veten nga një dëmtim i pësuar para ndeshjes. Prapëseprapë, ishte në formë. Ajo gjuajti dy kundërshtare, duke i paralizuar për disa rënie daullesh. Hektori e kuptoi vetë si ishte puna. Ajo i mbajti të dyja poshtë në tokë, duke i lënë shteg kuikut të saj dhe zinxhirit që të mbështilleshin të tëra dhe ta mbulonin. Vrapuan bashkarisht, duke tentuar të bënin një ngjitime.

I bllokuan, dhe të dyja ranë në gjunjë, me kafkën tek rrotullohej përdhe. Ishte mbuluar në gjak me ngjyrë rozë. Peti bëri përpara dhe e mbuloi kuikun e saj ndërkohë që rimerrte veten, por ishte shumë për të, pasi të gjitha ishin në sulm ndaj saj.

Iu shmang njëres prej skuadrës së të Dashurave, por të tjerat e hodhën poshtë me goditje. Në mikrofonët e stadiumit u dëgjua një kërcitje e brinjëve të saj. Një goditje tjetër me shtizë, dhe Peti u rrëzua, me gjakun ngjyrë rozë që spërkati të gjithë trupin e të Dashurës. Turma reagoi me një drithërimë kolektive.

Të Dashurat e Shkatërrimit nuk reshtën së godituri Petin përdhe, dhe arbitri i shtyu mbrapa, duke u bërë titur në fytyrë.

Hektori e ndjeu veten të shqetësuar. “Ato kurvat e dreqit!”

“Krejtësisht,” E aprovoi Toni.

“A është e rregullt kjo?”

“Jo, vërtet. Do marrin një paralajmërim,” tha ai thjesht. Pastaj shtypi me dorë një kanaçe dhe e flaku poshtë në dysheme.

“Paralajmërim?” Ulëriti Hektori. “Ato sapo e bënë për spital!”

Toni u kthye nga ai dhe mblodhi supet. “Çfarë do që të të them, o njeri?”

Hektori ngeli pa fjalë.

#### PJESA E TREMBËDHJETË

Ambulanca ndriçoi rrugën në drita blu. Ishte natën vonë. Nga dritaret e tyre, njerëzit kundronin jashtë, për të parë me kureshtje se çfarë ishte gjithë ajo zhurmë.

“E çuditshmja është se, në lagjen e tij, zakonisht ne marrim, nuk shpërndajmë. Vër firmën këtu, të lutem,” i tha mjeku dhe i nxori një tablet që ta firmoste elektronikisht.

“Ti nuk mund ta lësh atë këtu,” U ankua Hektori.

Mjeku e vështroi në fytyrë. “A nuk jeni ju pronari i regjistruar i kësaj atleteje?”

“Po... Por-”

“Atëherë, është problemi juaj, jo i imi. E rregulluan aty poshtë në ER dhe tani ajo ka nevojë vetëm të marrë veten. Mund t’i hedhësh një sy Pyetjeve të Shpejta në sitin tonë të web-it për udhëzime apo diçka tjetër që mund të të duhet.”

“Cili sit web?”

“Thjesht shiko tek Pyetjet e Zakonshme mbi Cyberpink-un në sitin Apollo Medical.”

Hektori rrahu qepallat dhe theksoi duke pyetur. “Pra kjo është e zakonshme?”

“Më shumë se sa mund ta mendosh,” i tha mjeku dhe kontrollloi fletat. U duk i kënaqur dhe thirri kolegun e tij, i cili u bë gati të shtynte nga mbrapa ambulancës. “Kështu pra, ku e do?”

## **Конец ознакомительного фрагмента.**

Текст предоставлен ООО «ЛитРес».

Прочитайте эту книгу целиком, [купив полную легальную версию](#) на ЛитРес.

Безопасно оплатить книгу можно банковской картой Visa, MasterCard, Maestro, со счета мобильного телефона, с платежного терминала, в салоне МТС или Связной, через PayPal, WebMoney, Яндекс.Деньги, QIWI Кошелек, бонусными картами или другим удобным Вам способом.